



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.198/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ramush Bardiqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Kujtim Pasuli anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës IRDK, me seli në Pejë, kundër Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane PLE, me seli në Gjakovë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 28.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.198/2025 e datës 25.01.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Gjakovë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 25.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik IRDK, me të cilën pretendon se mbështetësi i Subjektit Politik PLE, Avdullah Qafani, njehërit ish kandidat në zgjedhje nga Partia Liberale Egjiptiane - PLE në profilin e tij në facebook, ka publikuar një shkrim në të cilin ka përdorur gjuhë nxitëse për urrejtje përpiqet të dëmtojë imazhin e kandidatit me nr. 16 të IRDK-së Eros Gashi, ku ndër të tjerash thotë; "...po nisem për Kosovë me qellim që t'ju tregoj arsytet (...) pse kam kërkuar që kandidati numër 16 të largohet nga lista. Injorimi i kësaj kërkesë ka si pasojë përfundimin e heshtjes sime dhe të neutralitetit të këtyre zgjedhjeve. (...) unë e di fuqinë e tij. Unë e njoh si shume të dobët dhe këtë do e elaboroj me rastin e ardhjes sime në vendlindje. (...) Nuk thuhet kot se shkolla nuk të bene njeri. (...) Fatkeqësisht disa nga të shkolluarit janë shkalle të larte të oportunitizmit gjë që i sjell shume dëm interesave të komunitetit tone në grupin e të cilëve bën numri 16 e i cili shkrim e kuptimson dhe është vazhdimësi e shkrimit paraprak ku thotë: ".bej ftese që kandidatin nen numrin rendor 16 ta hiqni nga lista për kandidim. (...) Nuk kam dëshire të ndikoj ne rezultatin e zgjedhjeve por... (...) Ardhja ime urgjente ne Kosove, paraqitja publike në shumicën e televizioneve të vendit ku do ti beja publike komunikimet e mia me të përmendurin dhe sjelljet e tij që kane kontribuar më së shumti që kundër meje të përdoret dhuna fizike e të largohem me force nga ndërtesa e qeverise (...) do t'ju paraqiste si jo të sinqerte ne premtimet dhe proklamimet e juaja.

Me tutje parashtruesi i ankesës thekson se theksimet e lartcekura përbejnë shkelje sipas nenit 34 (1.11) të Ligjit Nr. 08/1--228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sepse ka përdorur gjuhën, në formën e shkruar, duke nxitur ose provokuar, ose duke mundur të nxisë apo provokojë në urrejtje kundrejt të tjerëve, që përben veprim të ndaluar të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur Foton e tij të profilit në facebook me datë 23.01.2025, në ora 22:20, dhe postimi në facebook dt. 23.01.2025, si dhe Postimi i tij në facebook.

Më datë 26.01.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektin Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datën 27.01.2025 në ora 12:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 27.01.2025, Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), thekson se e kundërshton në tërësi ankesën për faktin se shkrimi i Avdullahut është personal dhe individual dhe nuk ka të bëjë me subjektin politik PLE dhe teksti e personi në fjalë nuk pasqyron asgjë nga qëndrimet politike të PLE, pra Avdullah Qafani nuk është në strukturat politike të PLE-së, nuk është kandidat për Zgjedhjet e Përgjithshme të 09.02.2025 andaj opinionet e qytetarit që pasqyrohen në profile të facebook personale janë qëndrime individuale dhe nuk mund merren se u përkasin subjekteve politike të caktuara. Vlen të cekim se Avdullah Qafani nuk jeton dhe vepron në Kosovë, për dijeninë tuaj i njëjti jeton në Dubai, ku sipas informatave c ushtron profesionin c doktorit të mjekësisë.

Ju kujtojmë se partitë politike nuk mund të përgjigjen për shkrimet, publikimet e simpatizantëve ngase kjo nuk ka logjikë që partitë politike të mbajnë përgjegjësi për qindra e mijëra simpatizant. Pra, ju kujtojmë se Avdullah Qafani në shkrimin e publikuar në facebook e të paraqitur me ankesë askund nuk ka përmendur subjektin politik PLE, rrjedhimisht postimet c tij në facebook janë për çështje personale që mund të ketë i njëjti me këndo prej qytetarëve të Kosovës dhe assesi nuk mund të ndërlidhet apo thirret para përgjegjësisë subjekti politik PLE përgjegjësisë subjekti politik PLE.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik PLE, ka bashkangjitur Listën e Kandidatëve për Zgjedhjet e 09 Shkurtit 2025 ku emri i tij nuk figuron askund.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik PLE, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik IRDK, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose*

duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Paneli i ankesave ka refuzuar pretendimin në ankese për arsye se, në baze të shkresave të lëndes vërtetohet se postimi i Avdullahu Qafanit është personal dhe individual dhe nuk ka të bëjë me subjektin politik PLE dhe teksti e personi në fjalë nuk pasqyron asgjë nga qëndrimet politike të PLE, pra Avdullah Qafani nuk është në strukturat politike të PLE-së, nuk është kandidat për Zgjedhjet e Përgjithshme të 09.02.2025.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.198/2025 më datë 28.01.2025



Kryesues i Panelit
Ramush Bardiqi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i martjes-pranimit të këtij vendimi.